

## GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË

P. Nr. 06/09

15 korrik 2010

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË**, në Trupin Gjykes të përbërë prej Gjykatëses së EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati, në cilësinë e Kryetares së Trupit Gjykes, Gjykatësve të EULEX-it Charles L. Smith, III dhe Nikolay Entchev në cilësinë e anëtarëve të Trupit Gjykes, me pjesëmarrjen e Këshilltares Juridike të EULEX-it Zane Ratnicec, në cilësinë e procesmbajtëses, në lëndën penale kundër:

**A. A.**, të akuzuar, në bazë të Aktakuzës së Prokurorit Publik të Qarkut PP. Nr. 112/08, të datës 13 janar 2009, dhe e regjistruar në Sekretarinë e Gjyqit të Qarkut të Mitrovicës më 14 janar 2009, me veprën penale të **Vrasjes së Rëndë në Tentative**, në kundërshtim me Nenin 147 Pika 4 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) që lexohet me nenin 20 të KPK-së;

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor të cilat ishin të hapura për publikun më 12, 13, 14 dhe 15 korrik 2010, të gjitha në prezencën e të Akuzuarit **A.A.**, Avokatit të tij Mbrojtës **H.H.**, Prokurores së EULEX-it Neeta Aminit, të Palëve të Dëmtuara **B.A.**, **C.A.** dhe **D.A.** (përveç sesionit të pasdrekes më 14 korrik 2010, Përfaqësueses së tyre të Autorizuar **B.B.**), pas shqyrtimit të bërë nga ana e Trupit Gjykes dhe votimit të mbajtur më 15 korrik 2010, në pajtim me Nenin 392 Paragrafi (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), shpalli publikisht dhe në praninë e të Akuzuarit, Avokatit të tij Mbrojtës, Prokurorit Publik të EULEX-it, Palëve të Dëmtuara dhe Përfaqësuesve të tyre të Autorizuar, në vijim

### AKTGJYKIMIN

I akuzuari **A.A.**, i biri i **E.A.** dhe **H.S.**, i lindur më **...**, në Fshatin **M.**, Komuna e Vushtrrisë, shqiptar Kosovar, me vendbanim në Fshatin Mihaliq, Komuna e **...**, me shkollë të mesme të kryer, punëtor, të gjendjes së varfër ekonomike, i martuar dhe babë i katër fëmijëve, më herët i dënuar për Falsifikim të Dokumentit dhe i dënuar me gjobë, në paraburgim në mes të 20 tetorit 2008 dhe 20 marsit 2008 si dhe që nga 20 marsi 2010;

është

## FAJTOR

A) sepse më 20 tetor 2008 rreth orës 20:30, në Fshatin H., Komuna e Vushtrrisë, në shtëpinë e tij i akuzuari me qëllim të vrasjes, e ka sulmuar gruan e tij me një brisk xhepi e cila me ndihmën e djemve të saj, arriti me ikë në shtëpinë e kumatit të saj. F.A. I akuzuari e ndoqi gruan e tij dhe në shtëpinë e F.A. i akuzuari vazhdoi të sulmonte gruan e tij me brisk me ç'rast i shkaktoi lëndime të prerjes në kokë dhe në të dy krihet para se të ndalej nga djali i tij C.A. bashkë me të vëllain e tij F.A.

Duke vepruar në këtë mënyrë, i akuzuari A.A. ka kryer dhe penalisht është përgjegjës për veprën penale të

**Vrasjes në Tentativë** sipas Nenit 146 që lexohet bashkë me Nenin 20 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK).

B) sepse i akuzuari më 20 tetor 2008 rreth orës 20.30, në Fshatin H., në shtëpinë e tij dhe në shtëpinë e vëllait të tij F.A. i ka shkaktuar lëndime të prerjes në krahun e djathtë dhe në pjesën e sipërme të brendshme të kofshës së djalit të tij C.A. i cili tentoi që të mbronte nënën e tij B.A. nga sulmi sipas pikës A).

Duke vepruar në këtë mënyrë, i akuzuari A.A. ka kryer dhe penalisht është përgjegjës për veprën penale të

**Lëndimit të Lehtë Trupor**, Lëndimit të Lehtë Trupor, sipas nenit 153 paragrafi (4) që lexohet me Paragrafin (2) dhe Paragrafin (1) Pika 1) të KPPK-së.

I akuzuari A.A. është

## DËNUAR

- me tetë (8) vjet burg për veprën penale të Vrasjes në Tentativë / pika A)
- me dy (2) vjet burg për veprën penale të Lëndimit të Lehtë Trupor / pika B).

Dënimi unik është caktuar me nëntë (9) vjet burg, në pajtim me Nenin 71 Paragrafi (1) dhe Paragrafi (2) Pika 2 të KPPK-së.

Koha e kaluar në paraburgim në mes të 20 tetorit 2008 dhe 20 marsit 2009 dhe që nga 20 marsi 2010 do të llogaritet në pajtim me Nenin 73 Paragrafi (1) të KPPK-së.

I akuzuari *Å.Å.* do të kompensojë shpenzimet e procedurave penale në pajtim me Nenin 102 Paragrafi (1) të KPPK-së me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit me gojë dhe me shkrim. Lidhur me shumën e shpenzimeve një Aktvendim i posaçëm do të lëshohet nga ana e Gjykatës atëherë kur të grumbullohen shënimet gjegjëse në pajtim me Nenin 100 Paragrafi (2) të KPPK-së.

## ARSYETIMI

### I. HISTORIKU PROCEDURAL

#### 1.1. *Aktakuza*

Më 14 janar 2009, Prokurori Publik i Qarkut për Mitrovicë Xhevdet Bislimi ngriti Aktakuzën PP Nr. 112/08, më datën 13 janar 2009, në Sekretarinë e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë.

Sipas Aktakuzës i akuzuari *Å.Å.* ishte akuzuar me veprën penale të Vrasjes së Rëndë në Tentativë sipas Nenit 146 Pika 4 që lexohet bashkë me Nenin 20 të KPK-së. Aktakuza është konfirmuar më 29 mars 2010.

### II. JURIDIKSIONI I GJYKATËS

#### 2.1. *Kompetenca lëndore dhe territoriale*

Sipas Nenit 23 paragrafit (1) të KPPK-së, një gjykatë e qarkut do të ketë juridiksionin që të gjykojë në instancën e parë një veprë penale që është e dënueshme me burgim me së paku pesë vjet apo me burgim afatgjatë. Vepra penale për të cilën është akuzuar, Vrasje të Rëndë në Tentativë lejon dënimin me burgim me së paku pesë (5) vjet.

Prandaj, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë e ka juridiksionin e çështjes së lëndës mbi këtë lëndë.

Vepra penale për të cilën është akuzuar, Vrasje të Rëndë në Tentativë supozohet se është kryer në Fshatin *U. . .*, Komuna e Vushtrrisë.<sup>1</sup>

Prandaj, në pajtim me Nenin 27 Paragrafi (1) të KPPK-së, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë e ka po ashtu edhe juridiksionin mbi këtë lëndë.

## 2.2. Juridiksioni i Gjykatësve të EULEX-it

Neni 3.3 të Ligjit Nr.03/L-053 'Mbi Juridiksionin, Zgjedhjen e Lëndëve dhe Ndarjen e Lëndëve Gjykatësve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë' konstaton se në rastet e kompetencës dytësore, gjykatësit e EULEX-it mund të marrin lëndën pas caktimit nga ana e Presidentit të Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it. Më 14 tetor 2009 Presidentja e Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it, pas kërkesës së Prokurorit të EULEX-it, vendosi që t'i caktojë gjykatësit e Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës në këtë lëndë. Gjykatësit e EULEX-it nga Gjykata e Qarkut të Mitrovicës janë caktuar në këtë lëndë po ashtu në bazë të Nenit 3.5 të Ligjit Nr.03/L-053 për të siguruar administrimin e përkryer të drejtësisë.

## III. LIGJI I APLIKUESHËM

### 3.1. Ligji i mirëfilltë i aplikueshëm

Vepra penale për të cilën është akuzuar, Vrasje e Rëndë në Tentativë supozohet se është kryer më 20 tetor 2008. Ligji i mirëfilltë i aplikueshëm në këtë rast është ai që ka qenë në fuqi kur vepra penale është kryer.

I akuzuari *A. A.* sipas Aktakuzës PP Nr. 112/08 ishte akuzuar në pajtim me Kodin Penal të Kosovës (KPK). Kodi ishte emëruar KPK duke hyrë në fuqi që nga 06 janari 2009, e cila gjë është bërë *pasi* që i akuzuari supozohej se e kishte kryer veprën penale të akuzuar. Në kohën kur i akuzuari e kishte kryer veprën penale, më 20 tetor 2008, kodi ishte i emërtuar Kodi i Penal i Përkohshëm i Kosovës (KPPK), i adoptuar me anë të Rregullores së UNMIK-ut 2003/25, që ka hyrë në fuqi më 06 prill 2004.

KPK në krahasim me KPPK-në nuk është më i favorshëm në rastin në fjalë.

Prandaj, edhe pse Aktakuza e akuzonte të akuzuarin sipas KPK-së, Trupi Gjykses megjithatë e aplikoi KPPK-në.

<sup>1</sup> Aktakuza PP Nr. 112/08, e datës 13 janar 2009

### 3.2. Ligji i aplikueshëm procedural

Ligji i aplikueshëm procedural është ai, i cili është në fuqi në momentin kur procedurat udhëhiqen. Në kohën e procedurave Gjyqësore në fuqi ka qenë Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK). Prandaj, Gjykata e ka zhvilluar procedurën në pajtim me KPPK-në.

## IV. PËRMBLEDHJA E PROVAVE TË PREZANTUARA

4.1. Personat e poshtëshënuar janë dëgjuar në cilësinë e dëshmitarëve gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor:

- 1) Pala e dëmtuar B. A. , gruaja e të akuzuarit, më 12 korrik 2010;
- 2) Pala e dëmtuar C. A. , i biri i të akuzuarit, më 12 korrik 2010;
- 3) Pala e dëmtuar D. A. , i biri i të akuzuarit, më 12 korrik 2010;
- 4) F. A. , i vëllai i të akuzuarit, më 13 korrik 2010;
- 5) G. A. , gruaja e F. A. , të vëllait të akuzuarit, më 13 korrik 2010;
- 6) H. A. , i biri vëllait F. A. dhe të kunatës G. A. , më 13 korrik 2010;
- 7) Dr. R. R. , më 14 korrik 2010;
- 8) Dr. S. S. , më 14 korrik 2010.

4.2. Deklarata e dëshmitarit në vijim është lexuar më 13 korrik 2010:

- 1) E. A. , babai i të akuzuarit, i vdekur, deklarata e tij e dhënë para Shërbimit të Policisë së Kosovës, më 22 tetor 2008, numri i lëndës 2008

4.3. Deklaratat e dëshmitarëve dhe provat në vijim janë prezantuar nga a Prokurorit Publik të EULEX-it gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor:

- 1) Deklarata e palës së dëmtuar B. A. dhënë para Shërbimit Policor të Kosovës, më 20 tetor 2008, numri i lëndës 2008 ;
- 2) Deklarata e palës së dëmtuar C. A. dhënë para Shërbimit Policor të Kosovës, më 20 tetor 2008, numri i lëndës 2008 ;
- 3) Deklarata e F. A. dhënë para Shërbimit Policor të Kosovës, më 20 tetor 2008, numri i lëndës 2008- ;
- 4) Raporti mjekësor për C. A. numri , të datës 31 gusht 2009, i lëshuar nga by Dr. R. R. ;
- 5) Udhëzimi te mjeku specialist për C. A. , të datës 20 tetor 2008, i nënshkruar nga Dr. R. R. dhe Dr. S. S. ;

- 6) Raporti mjekësor për B.A., numri , të datës 31 gusht 2009, i lëshuar nga Dr. R.R.;
  - 7) Udhëzimi te mjeku specialist për B.A., të datës 20 tetor 2008, i nënshkruar nga Dr. R.R. dhe Dr. S.S.
- 4.4. Dokumentet në vijim propozuar nga Prokurori Publik i EULEX-it që të përdoren në cilësinë e provave, dhe janë konsideruar si të lexuara në bazë të pajtimit me palët:
- 1) Raporti Psikiatrik për A.A., nga Departamenti i Psikiatrisë së Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, të datës 09 janar 2009 (ekzaminimi psikiatrik i bërë në bazë të urdhrit të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës më 17 nëntor 2008);
  - 2) Raporti Psikiatrik për A.A., nga Departamenti i Psikiatrisë së Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, të datës 09 janar 2009 (ekzaminimi psikiatrik i bërë në bazë të urdhrit të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës më 29 prill 2010);
  - 3) Raporti fillestar i Incidentit , të datës 20 tetor 2008, numri i lëndës 2008- , numri i referencës ;
  - 4) Raporti i Identifikues i Forenzikës, të datës 20 tetor 2008;
  - 5) Raporti i Hetimeve, të datës 21 tetor 2008, nga oficerët dhe ;
  - 6) Raporti i Oficerit të Policisë, të datës 20 tetor 2008, nga oficeri ;
  - 7) Raporti i Oficerit të Policisë, të datës 20 tetor 2008, nga Oficerët dhe ;
  - 8) Raporti mbi vendin e ngjarjes, të datës 20 tetor 2008, nga Oficeri ;
  - 9) Skica e vendit të ngjarjes, të datës 20 tetor 2008, numri I lëndës 2008- , nga Oficeri ;
  - 10) Foto albumi numër , të datës 20 tetor 2008, nga Oficeri , duke përfshirë përshkrimin e fotografive dhe të fotografive (sic).

## V. VLERËSIMI I PROVAVE TË PREZANTUARA

### 5.1. Konstatimet faktike

Duke u bazuar në provat e prezantuara gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor, gjykata i konsideroi faktet në vijim si të vërtetuara:

Më 20 tetor 2008, rreth orës 20:30, në Fshatin H., Komuna e Vushtrrisë, i akuzuari A.A., gruaja e tij B.A. dhe djemtë e tyre C. dhe D.A. ishin ulur në dhomën e ndejës të shtëpisë së tyre. I akuzuari A.A. filloi të sulmonte gruan e tij B.A. dhe papritmas nxori nga xhepi një brisk xhepi. I

akuzuari me qëllim që të vriste gruan e tij tentoi ta godiste atë me briskun e tij të xhepi, mirëpo djemtë e tyre C.A. dhe D.A. intervenuan për të mbrojtur nënën e tyre nga sulmi. B.A. iku nga shtëpia dhe vrapoi në shtëpinë e F.A. që ishte në afërsi, i cili është i vëllai i të akuzuarit. I akuzuari A.A. dhe C.A. ishin duke e ndjekur B.A. për në shtëpinë e F.A. B.A. vrapoi në shtëpinë e F.A. duke piskatë dhe kërkuar ndihmë, ku F.A., gruaja e tij G.A., dhe djali i tyre H.A. ishin të pranishëm. Po ashtu, C.A. dhe A.A. ishin duke përcjellë, ku C.A. ishte duke tentuar që ta mbronte nënën e tij. Para se të arrinte F.A. që të intervenonte, i akuzuari vazhdoi të sulmonte gruan e tij me brisk të xhepit. I akuzuari gjatë sulmit kundër gruas së tij i shkaktoi asaj lëndime të prerjes në kokë dhe në të dy krihet. I akuzuari po ashtu shkaktoi lëndime të prerjes në krahun e djathtë dhe në pjesën e brendshme të epërme të kofshës djalit të tij C.A. i cili tentoi që ta mbronte nënën e tij nga sulmi. I vëllai i të akuzuarit F.A. intervenoi, dhe bashkë me C.A. e kapën të akuzuarin dhe e mbajtën. B.A. iku lartë katin e epërm në shtëpinë e F.A. Pastaj A.A. kërkoi që ta lëshonin. Deri sa ishte duke shkuar, ai u takua me G.A., gruan e F.A. I akuzuari e pyeti G.A. se ku ishte B.A.. Kësaj pyetjeje G.A. u përgjigj duke thënë se ajo kishte ikur diku jashtë. A.A. u nis dhe shkoi drejtë në shtëpinë e tij, ku djali i tij D.A. e shërbeu me çaj.

## 5.2. Provat që vërtetojnë konstatimet faktike

a. Pala e dëmtuar B.A. është ekzaminuar në cilësinë e dëshmitares në gjykimin kryesor më 12 korrik 2010. Ajo dëshmoi se edhe gjatë ditës së 20 tetorit 2008 bashkëshorti i saj A.A. ishte i shqetësuar dhe nervoz, dhe bërtiste në te dhe në fëmijët, sepse ai nuk mund të gjente certifikatën e kurorëzimit.<sup>2</sup> Pas darkës djali i tyre C.A. erdhi në shtëpi. I akuzuari filloi me e pyet C.A. lidhur me certifikatë e kurorëzimit të humbur, i cili u përgjigj se e njëjta ishte në komunë. Situata u rëndua dhe A.A. tentoi të qëllonte gruan e tij, por u ndalua nga ana e djemve të tyre më të mëdhenj.<sup>3</sup> B.A. doli nga shtëpia dhe shkoi në shtëpinë e F.A. (i vëllai i të akuzuarit). Po ashtu edhe A.A. shkoi atje dhe e përdori briskun e xhepit kundër saj, duke e goditur atë në kokë dhe në krahë. C.A. ishte gjithnjë duke tentuar që ta mbronte B.A., dhe po ashtu u godit me briskun e xhepit. Brisku i xhepit, sipas B.A. ishte përafërsisht 10 cm i gjatë kur ishte i hapur.<sup>4</sup>

<sup>2</sup> Procesverbali nga seanca dëgjimore e shqyritimit gjyqësor më 12 korrik 2010, f.8, 17 (në gjuhën angleze)

<sup>3</sup> ibid, fq.9, 10

<sup>4</sup> ibid, fq.10, 11, 19

Në seancën dëgjimore të shqyrtimit gjyqësor pala e dëmtuar B.A. e konfirmoi deklaratën e saj që e kishte dhënë para Shërbimit Policor të Kosovës më 20 tetor 2008, numri i lëndës 2008- , ku kishte deklaruar se deri sa ishte në shtëpinë e tyre A.A. e kishte nxjerr briskun nga xhepi i tij dhe kishte tentuar me e sulmua atë me brisk.

b. pala e dëmtuar C.A. , gjatë marrjes në pyetje në seancën dëgjimore të shqyrtimit gjyqësor më 12 korrik 2010, pjesërisht e vërtetoi deklaratën e nënës së tij B.A. . Ai konfirmoi se ishte i pranishëm më 20 tetor 2008, bashkë me babën e tij A.A. dhe nënën B.A. . Në atë ditë babai i tij ka qenë i hidhëruar sepse nuk mund të gjente certifikatën e kurorëzimit, dhe ishte duke piskatë lidhur me te. Rreth orës 20:30 A.A. e nxori një brisk, me një teh prej 5 – 6 cm dhe tentoi të sulmonte B.A. , por C.A. bashkë me vëllain e tij D.A. ishin duke tentuar që ta mbronin nënën e tyre nga sulmi.<sup>5</sup>

Gjatë ekzaminimit në seancën dëgjimore të shqyrtimit gjyqësor C.A. e kundërshtoi deklaratën e nënës së tij duke thënë si në vijim: babai i tij A.A. e përdori briskun kundër nënës së tyre vetëm në shtëpinë e tyre (siç është përshkruar këtu më lart). Disa nga lëndimet e nënës së tyre ishin shkaktuar sepse ajo kishte rrëshqitë në shkallë. Lëndimet e B.A. pjesërisht ishin shkaktuar nga ana e të akuzuarit A.A. dhe pjesërisht nga ai dhe vëllai i tij D.A. . Edhe pse gjatë seancës dëgjimore të shqyrtimit gjyqësor C.A. pranoi se babai i tij po ashtu e kishte lënduar atë, ai deklaroi se kjo nuk ishte bërë me brisk por nga goditja me dorë.<sup>6</sup> Trupi Gjykyes e konsideroi deklaratën e C.A. në atë pjesën që e kundërshtonte deklaratën e B.A. dhe gjeti se ajo nuk ishte e besueshme për shkak të:

- **Raporti mjekësor** për C.A. , numër , i datës 31 gusht 2009, i lëshuar nga Dr. R.R. , dhe **udhëzimi për te mjeku specialist** për C.A. , i datës 20 tetor 2008, i nënshkruar nga Dr. R.R. dhe Dr. S.S. , qartazi tregonte se C.A. kishte pësuar lëndime të prerjes në krah dhe në pjesën e brendshme të epërme të kofshës. Prandaj, Trupi Gjykyes konsideroi se lëndimet e C.A. ishin shkaktuar nga ana e A.A. me të njëjtin brisk, me të cilin A.A. po sulmonte gruan a tij, e jo me dorë ashtu siç pohohej nga ana e C.A. gjatë seancës dëgjimore të shqyrtimit gjyqësor më 12 korrik 2010.
- Dëshmitarët F.A. dhe G.A. dëshmuan në seancën dëgjimore të shqyrtimit gjyqësor më 13 korrik 2010 se më 20 tetor 2008 rreth orës 20.40, B.A. erdhi në shtëpinë e tyre, e ndjekur nga ana e C.A. dhe A.A. . Që të dy dëshmitarët konfirmuan se A.A. e përdori briskun e tij kundër B.A. në shtëpinë e tyre, ata po ashtu konfirmuan se C.A.

<sup>5</sup> ibid, fq.25-28, 32

<sup>6</sup> ibid, fq.28-30, 37

ishite aty duke tentuar që ta mbronte nënën e tij nga sulmi.<sup>7</sup> Prandaj, Trupi Gjykses konkludon se A.A. vazhdoi që të sulmonte B.A. jashtë shtëpisë së tyre, në shtëpinë e vëllait të tij F.A.

- Në Deklaratën para Shërbimit Policor të Kosovës, të dhënë më 20 tetor 2008, numri i lëndës 2008-... C.A. në mënyrë të qartë kishte dëshmuar se babai i tij A.A. e kishte sulmuar atë dhe nënën e tij dhe i kishte ther të dytë. Kjo në vijim është thënë nga by C.A.: 'Ai më theri mua, deri sa isha duke tentuar ta mbroja nënën time. Ai më theri dy herë.' Edhe pse në seancën dëgjimore të shqyrtimit gjyqësor më 12 korrik 2010 C.A. thoshte se kjo deklaratë nuk ishte krejtësisht e vërtetë, megjithatë Trupi Gjykses ishte i mendimit se ajo ishte e besueshme. Sepse kjo deklaratë ishte dhënë nga C.A. pak kohë pas incidentit, dhe mbështetej në mënyrë të qartë me provat tjera në dosjen e lëndës.

c. Pala e dëmtuar D.A. dëshmoi në seancën dëgjimore të shqyrtimit gjyqësor më 12 korrik 2010. D.A. mohoi se ai ishte i pranishëm në shtëpi më 20 tetor 2008 kur ndodhi incidenti. Ai deklaroi se ai kishte ardhur në shtëpi vetëm pasi që kishte përfunduar incidenti.<sup>8</sup> Kjo deklaratë i kundërshtonte deklaratat e B.A. dhe C.A.. Ata të dytë kanë konfirmuar se D.A. kishte qenë në shtëpi dhe deri sa A.A. ishte duke sulmuar B.A. në shtëpinë e tyre, që të dytë D.A. dhe C.A. tentonin që ta mbronin nënën e tyre nga sulmi. Prandaj, Trupi Gjykses ishte i mendimit se pavarësisht nga mohimi i D.A. se nuk ka qenë në shtëpi në kohën e incidentit, ai ka qenë i pranishëm aty dhe bashkë me të vëllain C.A. e mbronin nënën e tyre nga sulmi.

Në seancën dëgjimore të shqyrtimit gjyqësor më 12 korrik 2010 D.A. dëshmoi se ai kishte dëgjuar nga anëtarët e familjes së tij për incidentin. Atij i kishin treguar se babai i tij A.A. ishte bërë nervoz dhe e kishte sulmuar nënën dhe vëllain e tij C.A.. Veç kësaj, atij i kishin treguar se A.A. e kishte sulmuar nënën e tij me brisk. D.A. dëshmoi se pas incidentit ai u takua me vëllain e tij C.A. i cili i tregoi se babai i tyre e kishte lënduar atë në krah dhe në këmbë me brisk deri sa ai ishte duke e mbrojtur nënën e tij. D.A. e kishte parë briskun më herë të cilin A.A. e kishte përdorë gjatë incidentit dhe ai ishte nja 15-20 cm i gjatë duke përfshirë edhe tehun. Veç kësaj, D.A. dëshmoi se pas incidentit që kishte ndodhur, ai erdhi në shtëpi ku gjendej babai i tij. Sipas D.A., babai i tij ishte i qetë dhe e kishte shërbyer me çaj.<sup>9</sup>

<sup>7</sup> Procesverbal nga seanca dëgjimore e shqyrtimit gjyqësor më 13 korrik 2010, faqet 4-6, 12, 18-20 (në gjuhën angleze)

<sup>8</sup> Procesverbal nga seanca dëgjimore e shqyrtimit gjyqësor më 12 korrik 2010, faqet 38, 39 (në gjuhën angleze)

<sup>9</sup> ibid, fq. 39, 40, 41-44

d. Dëshmitarët F.A. dhe G.A. dëshmuar në seancën dëgjimore të shqyrtimit gjyqësor më 13 korrik 2010, - ata dhe djali i tyre H.A. kanë qenë në shtëpi më 20 tetor 2008. Rreth orës 20:40 B.A. ka hyrë në shtëpinë e tyre duke kërkuar ndihmë. C.A. dhe A.A. ishin duke e ndjekur. F.A. dëshmoi se në atë moment C.A. ishte në mes të babës së tij A.A. dhe nënës së tij B.A. Dëshmitari F.A. deklaroi se 'sikur të mos të kishte qenë ai (C.A.)...' Kur u kërkua që t'i sqaronte këto fjalë, dëshmitari F.A. e kompletoi fjalinë duke thënë se 'sikur të mos të kishte qenë C.A., do të ishte bërë më keq'. Ai po ashtu konfirmoi se në atë natë vëllai i tij A.A. ka qenë në një gjendje shpirtërore të rrezikshme.<sup>10</sup> Para se të arrinte F.A. që ta kapte të akuzuarin, B.A. kishte pësuar një lëndim me brisk në kokë. F.A. dhe C.A. arritën ta kapnin A.A. B.A. shkoi lartë në shtëpinë e F.A. dhe G.A. A.A. kërkonte që ta lëshonin. Deri sa A.A. ishte duke shkuar, ai u takua me G.A. të cilën e pyeti se ku ishte gruaja e tij. G.A. iu përgjigj duke thënë se ajo kishte ikur jashtë shtëpisë. G.A. konfirmoi se pas atij incidenti ajo kishte parë lëndime të përgjakshme në kokën dhe krahun e B.A., që ishin shkakuar nga A.A. gjatë sulmit që e kishte bërë me brisk.<sup>11</sup>

e. H.A. (i lindur në vitin 1991), i biri i F.A. dhe G.A., në seancën dëgjimore të shqyrtimit gjyqësor më 13 korrik 2010 konfirmoi se ai ka qenë i pranishëm atëherë kur B.A. kishte hyrë në shtëpinë e tyre, duke thënë se burri i saj donte që ta sulmonte atë. Pas B.A., erdhën C.A. dhe A.A. H.A. dëshmoi se në atë moment ai doli nga shtëpia.<sup>12</sup> E njëjta gjë është deklaruar edhe nga nëna e tij G.A.

Lidhur me deklaratat që janë dhënë nga palët e dëmtuara si dhe nga dëshmitarët në seancat dëgjimore të shqyrtimit gjyqësor më 12 dhe 13 korrik 2010, Trupi Gjykyes vuri re se ata u tërhoqën në disa pjesë të deklaratave të tyre të cilat i kishin dhënë pak kohë pas incidentit më 20 tetor 2008 para Shërbimit Policor të Kosovës, apo ata i kundërshtuan ato me vet deklaratat e tyre të cilat i kanë dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor. Ky ndryshim në deklaratat e tyre ka qenë shumë më i favorshëm për të akuzuarin A.A.:

- B.A. dëshmoi në seancën dëgjimore të shqyrtimit gjyqësor më 12 korrik 2010 se asaj nuk i kujtohej se a kishte thënë burri i saj A.A. deri sa tentonte që ta sulmonte atë. Mirëpo, pas incidentit më 20 tetor 2008, B.A. kishte deklaruar para Shërbimit Policor të Kosovës siç vijon: 'A.A.

<sup>10</sup> Procesverbali nga seanca dëgjimore e shqyrtimit gjyqësor më 13 korrik 2010, faqet. 6, 14, 15 (në gjuhën angleze)

<sup>11</sup> ibid, fq. 4-7, 17-21

<sup>12</sup> ibid, fq. 26-28

u ngrit dhe tentoi që të më grushtonte dhe pastaj e nxori një brisk nga xhepi i tij dhe tentoi që të më qëllonte me te. Mirëpo pasi që fëmijët të cilët ishin të pranishëm piskatën, ai iu bërtiti fëmijëve duke iu thënë: 'Mbylleni gojën se ua shqyej gojën.' Kur e pyetën gjatë seancës dëgjimore të shqyrtimit gjyqësor edhe një herë, se a i ishin thënë këto fjalë nga ana e të akuzuarit, B.A. u përgjigj duke thënë 'ndoshta', por asaj megjithatë 'nuk i kujtohej'.

- Kur u mor në pyetje nga ana e Prokurores Publike të EULEX-it në seancën dëgjimore të shqyrtimit gjyqësor më 12 korrik 2010, B.A. u përgjigj duke thënë se A.A. nuk ka qenë i dhunshëm ndaj saj apo fëmijëve para incidentit të 20 tetorit 2008. Ai ka qenë vetëm nervoz, dhe bërtiste kohë pas kohe por nuk e kishte sulmuar askënd. Kjo deklaratë në mënyrë të qartë ishte në kundërshtim me atë që B.A. kishte thënë më 20 tetor 2008 para Shërbimit Policor të Kosovës. Atje ajo kishte deklaruar se burri i saj A.A. kishte qenë i dhunshëm ndaj se për më gjatë se dy vite. Ajo kishte deklaruar se ai nuk i linte ata asnjëherë vetëm, dhe se kishte raste të cilat i kishin lajmëruar në polici më herët, dhe se kishte pasur edhe më shumë raste të cilat nuk i kishin lajmëruar. B.A. po ashtu konfirmoi se ajo kishte frikë me jetua me burrin e saj, se ajo nuk e ndiente veten të sigurt, dhe se burri i saj gjithnjë e kërcënonte se do ta mbyste at. Mirëpo, në seancën dëgjimore të shqyrtimit gjyqësor, kur u mor në pyetje nga Prokurorja Publike e EULEX-it, B.A. deklaroi se ajo tani e ndiente veten ndryshe. Dhe, kur u pyet nga Përfaqësuesi i saj i Autorizuar, ajo u përgjigj duke thënë se ajo tani ishte pajtuar me burrin e saj dhe dëshiron me jetua me te, dhe se nuk dëshiron që burri i saj të dënohet.

- C.A. në seancën dëgjimore të shqyrtimit gjyqësor më 12 korrik 2010 siguroi se ai e njeh babin e tij A.A. si një babë të mirë dhe se ata tani janë duke menduar që të vazhdojnë të jetojnë bashkë. Mirëpo, më 20 tetor 2008, C.A.

Shërbimit Policor të Kosovës i kishte deklaruar se ndodhte që i akuzuari të sulmonte çdo kënd, se ai është i rrezikshëm, dhe se ata e ndienin veten të rrezikuar, dhe se nuk kishte ndonjë shans që të jetonin bashkë me babën e tyre në të ardhmen.

- F.A. gjatë dëshmimit të tij në seancë dëgjimore të shqyrtimit gjyqësor më 13 korrik 2010, kur e përshkroi sulmin e A.A. kundër B.A. me brisk, në vazhdimësi i përdori fjalët duke thënë se A.A. e kishte "prekur" B.A. me brisk. Kurse, në deklaratën e tij para Shërbimit Policor të Kosovës më 20 tetor 2008, F.A. kishte thënë se i akuzuari kishte arritur me e "ther" B.A. në kokë. Më vonë në seancën dëgjimore të shqyrtimit gjyqësor kur u pyet F.A. që të sqaronte, se a e kishte "prekë" A.A. apo e kishte "ther" gruan e tij, F.A. tha se e kishte "ther".

- Më 20 tetor 2008, para Shërbimit Policor të Kosovës F.A. kishte deklaruar se gjatë incidentit A.A. kishte thënë se ai do ta blinte një armë dhe do t'i vriste të gjithë. Mirëpo, në seancë dëgjimore të shqyrtimit gjyqësor më 13 korrik 2010, atij nuk i kujtohej se A.A. kishte thënë një gjë të tillë. Në të njëjtën kohë, kur e pyetën se a ka qenë e vërtetë çdo gjë që kishte deklaruar para Shërbimit Policor të Kosovës, F.A. u përgjigj duke thënë "Po".
- Po ashtu, më 20 tetor 2008, para shërbimit Policor të Kosovës F.A. kishte deklaruar se ajo nuk ka qenë hera e parë që A.A. i kishte shkaktuar probleme familjes së tij. F.A. kishte thënë se ai nuk i kishte vizituar ata nja 6-7 muaj pasi që nuk kishte asnjë mundësi që të bisedonte me ta. Në seancën dëgjimore të shqyrtimit gjyqësor, së pari, F.A. vërtetoi se para incidenti më 20 tetor 2008 se ata nuk kishin pasur asnjë problem. Kur Prokurorja Publike e EULEX-it e ballafaqoi F.A. me deklaratën e tij të dhënë para Shërbimit Policor të Kosovës, F.A. shpjegoi se kishte qenë vetëm incidenti i datës 20 tetor 2008 dhe një incident tjetër i vogël.

Trupi Gjyqësor konstatoi dy arsye se pse një qasje më e butë është marrë ndaj

A.A. nga ana e palëve të dëmtuara dhe të dëshmitarëve gjatë seancave dëgjimore të shqyrtimit gjyqësor:

- F.A., vëllai i të akuzuarit, në deklaratën e tij në seancën dëgjimore të shqyrtimit gjyqësor më 13 korrik 2010 e karakterizoi A.A. si një njeri të qetë, por "nëse e ngucni, ai nuk do të tolerojë atë". Ai po ashtu e karakterizoi A.A. si një njeri të rrezikshëm atëherë kur A.A. është i shqetësuar. F.A. konfirmoi se më 20 tetor 2008, në kohën e incidentit, A.A. ka qenë në një gjendje shpirtërore të rrezikshme. F.A. po ashtu deklaroi se ai ishte munduar që të ishte i kujdesshëm me A.A. dhe të mos përlehej me te. Ai, po ashtu, e kishte këshilluar B.A. që t'i shmangej problemeve. Ai, po ashtu, përmendi se "nëse e rrenë apo e shqetëson atë (A.A.), ju do të mbysni njëri tjetrin brenda një minute".<sup>13</sup> Nga deklaratat e B.A. që e ka dhënë në seancën dëgjimore të shqyrtimit gjyqësor, u vu re se ajo dhe fëmijët e saj rrinin larg nga A.A. D.A., djali i të akuzuarit, konfirmoi se babai i tij e humb disponimin shpejt.<sup>14</sup> Veç kësaj, i akuzuari A.A. është dënuar nga Gjykata Komunale në Vushtrri më 09 shkurt 2010 për shkak të veprës penale Lëndim i Lehtë Trupor që e kishte kryer kundër djalit të tij, palës së dëmtuar C.A. më 18 dhjetor

<sup>13</sup> ibid, fq.9, 10, 15

<sup>14</sup> Procesverbal nga seance dëgjimore e shqyrtimit gjyqësor më 12 korrik 2010, faqet 12, 44 (në gjuhën angleze)

2009. Prandaj, pas incidentit të datës 20 tetor 2008, **A.A.** prapë e kishte sulmuar një anëtar të familjes. Ashtu siç u shpjegua nga ana e **D.A.** në seancën dëgjimore të shqyrtimit gjyqësor më 12 korrik 2010 ai po ashtu ka qenë i pranishëm kur babai i tij e kishte lënduar vëllain e tij **C.A.** më 18 dhjetor 2009. Kjo ishte bërë nga ana e **A.A.** sepse ai ia kishte dhënë djalit të tij **C.A.** një kartelë bankare për të tërhequr të holla nga automati i bankës. Mirëpo **C.A.** nuk e dinte numrin e PINIT kështu që kartela ngeli në automat për të cilën gjë babai i tyre ishte nervozuar. Ashtu siç u shtuar nga ana e **C.A.**, gjatë incidentit të datës 18 dhjetor 2009, babai i tij po ashtu e kishte tërhequr për flokësh nënën e tij, e cila kishte tentuar që ta mbronte **C.A.**<sup>15</sup>

Kjo që është thënë këtu më lart tregon se i akuzuari **A.A.** është njeri që zemërohet shpejt, agresiv dhe ka qenë i dhunshëm ndaj familjes së tij në shumë raste të ndryshme. Prandaj, Trupi Gjyqësor është i mendimit se anëtarët e familjes së tij gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e ndienin veten të sigurt që t'i konfirmonin deklaratat e tyre të para dhe të përshkruajnë raportin e tyre me të akuzuarin në përgjithësi, dhe e tërë kjo në prezencën e të akuzuarit **A.A.** në sallën e gjyqimit. Kjo ka qenë po ashtu se nëse do të lirohej **A.A.** nga paraburgimi apo arresti, ata do të viheshin në rrezik për atë që kanë deklaruar para gjykatës. Për këto arsye, Trupi Gjyqësor ishte i bindur se deklaratat e palëve të dëmtuara dhe të dëshmitarit **F.A.** ashtu siç janë dhënë para Shërbimit Policor të Kosovës pas incidentit më 20 tetor 2008, ishin të besueshme.

- Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 12 korrik 2010 **C.A.** dëshmoi se babai i tij, **A.A.** kishte qenë mbajtësi kryesor i familjes, dhe se ai kujdesej për familjen e tij duke siguruar gjithcka për jetesën. Ndërkohë që babai i tij kishte qenë në paraburgim, askush nuk u kujdes për ta. Familja ka katër fëmijë dhe ata nuk kanë asnjë të ardhur financiare dhe mbijetojnë vetëm nga ato që la **A.A.** përpara paraburgimit të tij.<sup>16</sup> **D.A.** deklaroi se babai i tyre është kreu i familjes dhe po që se babai i tyre do të dënohej, familja do të ishte në një gjendje të pashpresë për të jetuar. As vëllai i tij, **C.A.** dhe as ai vetë nuk punojnë, dhe ata nuk do të kenë asnjë mjet mbijetese.<sup>17</sup>

<sup>15</sup> ibid, fq.44, 34

<sup>16</sup> Si më sipër, fq.34

<sup>17</sup> Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor- seanca e datës 15 korrik 2010, fq.5

Gjithashtu i akuzuari A.A. deklaroi se ndërsa ishte në paraburgim, mori vesh se familja e tij po përpiquej të mbijetonte, dhe se ata kishin marrë para borxh, ndërsa ai po mendonte se si do të vazhdonin të mbijetonin.<sup>18</sup>

Duke u bazuar në sa u tha më sipër, trupi gjykues përdori një qasje më lehtësuese ndaj rrethanave të incidentit të datës 20 tetor 2008 dhe përshkrimi i situatës lidhur me A.A., u adoptua nga anëtarët e familjes së tij, sepse ata varen nga ai financiarisht. Po qe se A.A. do të dënohej, kjo gjë do ta vendoste familjen e tij në një situatë mjaft të vështirë ekonomike. Kështu që, ka mundësi që kjo të ketë qenë edhe arsyeja, se përse anëtarët e familjes së tij, i ndryshuan deklaratat e tyre gjatë shqyrtimit gjyqësor. Për këtë arsye, trupi gjykues nuk i mori parasysh këto ndryshime në deklaratat e tyre dhe mori në konsideratë deklaratat e dhëna më 20 tetor 2008.

f. Deklarata e babait të të akuzuarit E.A. dhënë përpara Shërbimit Policor të Kosovës më 22 tetor 2008, çëshjta nr. 2008- u lexua gjatë shqyrtimit gjyqësor në seancën e datës 13 korrik 2010. Kjo u bë duke u bazuar në Nenin 368, Paragrafi (1), Pika 1) e KPPK, meqë E.A. kishte vdekur përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor. Në deklaratën e tij E.A. kishte deklaruar *inter alia*: 'Atë natë unë isha duke fjetur dhe ata më thirrën e më thanë se A.A. do të na vrasë. Unë u zgjova dhe e pyeta: 'Cfarë ndodhi A.A.?' Ai më kapi dhe më shtyu. A.A. është agresiv lidhur me familjen, ndërsa përse i përket njerëzve që e rrethojnë ai sillet mjaft mirë.' Prandaj deklarata e E.A. e mbështet deklaratën e palëve të lënduara që atë mbrëmje të datës 20 tetor 2008, A.A. i kishte sulmuar ata në shtëpinë e tyre. Gjithashtu kjo konfirmon edhe karakteristikat e përgjithshme të A.A. që ishte agresiv ndaj familjes së tij.

g. **Referimi tek mjeku specialist për B.A.**, i datës 20 tetor 2008, nënshkruar nga Dr. R.R. dhe Dr. S.S., dhe **Raporti Mjekësor për B.A.**, numër , të datës 31 gusht 2009, lëshuar nga Dr. R.R.

identifikoi se më 20 tetor 2008 B.A. është mjekuar në spital në Vushtrri. Në të dyja dokumentet shkruhet se B.A. kishte plagë prerëse në rajonin e ballit, në rajonin e shpatullës dhe në rajonin e shpatullës së majtë. Plagët u trajtuan me qepje.

Dr. R.R. ishte mjeku i parë që e vizitoi B.A. më 20 tetor 2008. Më pas ai e dërgoi atë tek mjeku kirurg Dr. S.S., që mjekoi edhe plagët. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 14 korrik 2010 Dr. R.R. konfirmoi se B.A.

<sup>18</sup> Si më sipër

B.A. kishte plagë, të cilat ishin shkaktuar nga një objekt i mprehtë, dhe mundësia se këto plagë ishin shkaktuar nga vetë viktima u përjashtua, dhe se këto plagë nuk ishin plagët tipike të shkaktuara nga të rrëzuarit.<sup>19</sup>

Prandaj, raportet mjekësore dhe deklaratat e Dr. R.R., mbështesin deklaratën e B.A., se burri i saj e kishte goditur atë me thikë, dhe mbështesin deklaratat e dëshmitarëve F.A. dhe G.A. se A.A. e kishte sulmuar B.A. me thikë. Ajo mbështet gjithashtu edhe deklaratën fillestare të palës së lënduar C.A. të dhënë përpara Shërbimit Policor të Kosovës më 20 tetor 2008 që nëna e tij ishte goditur me thikë nga A.A. Prandaj, gjykata e konsideroi të pabesueshme edhe një një ndryshim tjetër të deklaratës së C.A. gjatë shqyrtimit gjyqësor të seancës së datës 12 korrik 2008, që lëndimet e B.A. ishin shkaktuar për shkak se ajo ra nga shkallët.

Për më tepër, Dr. S.S. gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 14 korrik 2010 përshkroi se edhe po qe se vetë plaga që B.A. kishte në kokë nuk do të ishte e rrezikshme, vendndodhja e saj ishte e rrezikshme. Si shembull, ai shpjegoi se po qe se thika do të kishte goditur në ndonjë vend tjetër afër plagës në kokë, ajo mund të kishte qenë një arterie në qafë, që gjendet 6 mm larg nga lëkura.<sup>20</sup>

h. **Referimi tek mjeku specialist për C.A.**, i datës 20 tetor 2008, i nënshkruar nga Dr. R.R. dhe Dr. S.S., dhe **Raporti Mjekësor për C.A.**, numër , i datës 31 gusht 2009, i lëshuar nga Dr. R.R., identifikoi se më 20 tetor 2008, C.A. ishte mjekuar në spitalin e Vushtrisë. Ato vërtetoni se C.A. kishte plagë prerëse në rajonin e shpatullës së majtë dhe në rajonin e pjesës së brendshme të kofshës, dhe se plagët ishin trajtuar me qepje. Edhe pse Udhëzimi dhe Raporti Mjekësor pohonin që C.A. kishte lëndime në regjionin e majtë të trupit, siç qartësohet nga C.A. në seancën e shqyrtimit gjyqësor më 12 korrik 2010, ai kishte pësuar lëndime në anën e djathtë,<sup>21</sup> gjë që, poashtu, mund të shihet në fotografitë në shkresat e lëndës (faqe 188 në dosjen e provave të Prokurorisë).

Sa për plagët që kishte marrë C.A., - Dr. S.S., që mjekoi plagët, gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 14 korrik 2010, konfirmoi se këto plagë ishin regjistruar si plagë prerëse.<sup>22</sup>

Prandaj, raportet mjekësore mbështesin deklaratën e palëve të dëmtuara se C.A. ishte goditur me thikë, ndërsa po e mbronte nënën e tij nga sulmi. Sic u përmend edhe me sipër në këtë Aktgjykim, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 12 korrik 2010, C.A. e ndryshoi deklaratën e dhënë në fillim përpara Shërbimit Policor të Kosovës më

<sup>19</sup> Procesverbal i seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 14 korrik 2010, fq.3-10, 16, 17 (në gjuhën angleze)

<sup>20</sup> Si më sipër, fq.20, 21

<sup>21</sup> Procesverbal i seancës së shqyrtimit gjyqësor 12 korrik 2010, faqe 30, 31 (në gjuhën angleze)

<sup>22</sup> Si më sipër, fq.19

20 tetor 2008, duke deklaruar se babai i tij në fakt e kishte goditur atë me grusht. Raportet mjekësore, siç u konfirmua nga Dr. R.R. dhe Dr. S.S. në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 14 korrik 2010, bën që ky ndryshim në deklaratën e

C.A. të jetë jo i besueshëm. Prandaj, trupi gjykues mori në konsideratë deklaratën e C.A., të dhënë më 20 tetor 2008, ku C.A. deklaroi se babai i tij, A.A. e kishte 'goditur me thikë' (atë) dy herë, meqë ai po përpiquej të mbronte nënën e tij.

i. **Raporti Kriminalistik i Identifikimit**, i datës 20 tetor 2008, thotë që në fshatin H., Komuna e Vushtrisë, në vendin e fillimit të incidentit – në shtëpinë e A.A., nuk u gjendën gjurmë. Megjithatë, në shtëpinë e F.A., e cila gjendet 100 metra larg nga shtëpia e të akuzuarit – kishte dy (2) njolla të kuqe, të ngjashme me gjakun, në dyshemenë e korridorit, dhe kishte po ashtu edhe njolla në dyshemenë e dhomës së ndenjes. Tek shkallët, që të conin në katin e dytë, ishte një (1) njollë e kuqe e ngjashme me gjakun, dhe një (1) njollë tek shkallët në katin e dytë. Në dyshemenë e banjës në katin e dytë, kishte njolla të kuqe, të ngjashme me gjakun.

Njollat e sipërpërmendura, të ngjashme me gjakun, në shtëpinë e F.A. u morën gjithashtu në fotografi që gjenden në **Albumin Fotografik** numër 08-113, të datës 20 tetor 2008. Fotografitë me numër 29, 30, 31, 32 treguan shumë njolla në dyshemenë e banjës.

Raporti Kriminalistik i Identifikimit, i datës 20 tetor 2008, dhe albumi fotografik numër , i datës 20 tetor 2008, konfirmojnë se B.A. dhe C.A. kishin pësuar lëndime me gjakosje. Për më tepër, provat mbështesin deklaratën e B.A., dëshmitarëve F.A. dhe G.A., se pasi F.A. dhe C.A. ia dolën të kapin A.A. B.A. u ngjit lart në shtëpinë e F.A. Kjo, sepse njollat e ngjashme me gjakun u gjetën në shkallët e katit të dytë dhe u gjetën edhe më shumë njolla në dyshemenë e banjës së katit të dytë, që ishin lënë aty nga B.A., për shkak të gjakderdhjes nga lëndimet.

### 5.3. *Situata faktike lidhur me lëndimin e aluduar të D.A.*

Aktakuza PP. Nr. 112/08, e datës 13 janar 2009, aludon se ndërsa A.A. ishte duke sulmuar gruan e tij në shtëpinë e F.A., ai gjithashtu i shkaktoi lëndime edhe djalit të tij D.A. Lidhur me këtë aludim të Aktakuzës, trupi gjykues konstatoi sa më poshtë vijon:

a. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 12 korrik 2010, D.A. e mohoi të ishte lënduar nga babai i tij. B.A. deklaroi në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 12 korrik 2010 se vetëm C.A. e ndoqi atë në shtëpinë e

F.A. , dhe se D.A. ndeji në shtëpi. Ajo gjithashtu konfirmoi se, ndërsa ishin në shtëpinë e tyre, D.A. nuk pësoi ndonjë lëndim, ndërsa po përpiquej ta mbronte atë nga sulmi. E njëjta gjë u dëshmuar edhe lidhur me C.A.

b. Lëndimet e pësuar nga B.A. dhe C.A. u mjekuan në spitalin e Vushtrisë, ashtu sic tregohet edhe në letrat rekomanduese të mjekut specialist dhe raportet mjekësore, të cilat, po ashtu, përshkruajnë vetë lëndimet (sic janë diskutuar në këtë Aktgjykim, më sipër). Megjithatë, sa për D.A., nuk ka patur prova të tilla të ngjashme. Në **Albumin Fotografik** numër , të datës 20 tetor 2008, fotografitë numër 33, 34 tregojnë një lëndim në dorën e majtë të D.A. Kur është pyetur lidhur me këtë lëndim gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 12 korrik 2010, B.A. dëshmoi se djali i saj, D.A. ishte lënduar duke përdorur një aparat bujqësor ndërsa po punonte tokën, një apo dy ditë përpara incidentit. Po ashtu, D.A. gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 12 korrik 2010, shpjegoi se ai i pësoi këto lëndime ndërsa ishte duke punuar, duke ndihmuar xhaxhain e tij, dhe se lëndimi ishte shkaktuar gjatë përdorimit të drapërit.

c. Edhe dëshmitarëve Dr. R.R. dhe Dr. S.S. iu tregua fotografia e sipërpërmendur nr. 34 gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 14 korrik 2010, dhe atyre iu kërkua të përshkruanin lëndimin. Dr. R.R. e karakterizoi lëndimin në fotografinë nr. 34 si një lëndim gjysëm-rrethor, i cili dukej më shumë si një gërvishtje se sa një prerje, ndoshta e bërë me anë të një objekti të fortë. Sipas Dr.

R.R., lëndimi mund të ishte shkaktuar 3, 4 ose 5 orë më parë, meqë gjaku në fotografi nuk e kishte ndryshuar ngjyrën. Po ashtu, Dr. S.S. e përshkroi lëndimin si një gërvishtje, sepse lëkura nuk ishte penetruar. Dr. S.S. nuk mundi të tregonte se sa i vjetër ishte lëndimi.

Prandaj, në bazë të këtyre shpjegimeve të mësipërme, trupi gjykues arriti në përfundimin se nuk ka prova të mjaftueshme që të provojnë përtej dyshimit të arsyeshëm se

A.A. gjatë sulmit ndaj gruas së tij, lëndoi po ashtu edhe djalin e tij, D.A.

#### 5.4. Situata faktike lidhur me gjendjen mendore të A.A.

Gjatë të gjithë seancave të shqyrtimit gjyqësor palët e lënduara dhe dëshmitarët përmendën se A.A. mund të jetë i sëmurë. Po ashtu, babai i të akuzuarit, E.A., në dëshminë dhënë përpara Shërbimit Policor të Kosovës më 22 tetor 2008, çështja numër 2008- , ka deklaruar se 'është e qartë se ai (A.A.) është shumë i sëmurë tani, por ai nuk do ta pranojë këtë gjë'. Çështja e gjendjes mendore të të

akuzuarit është ngritur, po ashtu, edhe nga avokati i tij mbrojtës, H.M. I akuzuari A.A. në fjalën e tij përfundimtare tha se ai nuk e di se si ndodhi incidenti i datës 20 tetor 2008 dhe se ai nuk ndihej mirë.<sup>23</sup> Lidhur me gjendjen mendore të të akuzuarit A.A., trupi gjykues vlerësoi sa më poshtë vijon:

a. **Raporti psikiatrik** për A.A., nga Departamenti i Psikiatrisë së Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, i datës 9 janar 2009 (ekzaminimi psikiatrik u krye në bazë të Urdhrit të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës, së datës 17 nëntor 2008) deklaroi se A.A. nuk kishte prezencë psikopatologjike dhe se nuk kishte asnjë crregullim psikik. Po ashtu, edhe një **Raport tjetër psikiatrik** për A.A., nga Klinika e Psikiatrisë së Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, i datës 17 qershor 2010 (ekzaminimi psikiatrik u krye në bazë të Urdhrit të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës, së datës 29 prill 2010) konfirmoi se A.A. as nuk kishte vuajtur më parë dhe as nuk vuante për momentin nga ndonjë crregullim mendor apo cilësi psikiatrike, dhe se nuk ka asnjë mungesë në zhvillimin e tij.

Duke pasur parasysh dy raportet psikiatrike, trupi gjykues arriti në përfundimin se nuk kishte prova që të sugjeronin se përgjegjësia penale e të akuzuarit për veprën penale të kryer më 20 tetor 2008 mund të përjashtohet, sipas Nenit 12 të KPPK, duke pasur parasysh inkompetencën mendore, apo faktin që përgjegjësia e tij penale mund të ishte ndikuar nga kapaciteti i zvogëluar mendor.

b. Sipas raportit më të fundit psikiatrik, në kohën e kryerjes së veprës penale të 20 tetorit 2008, dhe gjithashtu edhe për momentin, A.A. vuan nga crregullimi i personalitetit, ICD 10. Në raportin psikiatrik, karakteristikat e mëposhtme i janë atribuar A.A. personaliteti i pashoqërueshëm, me nivel të ulët tolerance në situata frustruese, ndërmerr akte dhune në mjedisin përreth duke demonstruar sjellje të pakontrolluar, gjithmonë dyshues. Raporti psikiatrik, theksoi po ashtu, se A.A. paraqet një tendencë përsëritëse (recidiviste) të sjelljes së dhunshme ndaj njerëzve që e rrethojnë.

Trupi gjykues thekson se çrregullimi i personalitetit duhet të dallohet nga sëmundja mendore, dhe prandaj nuk mund të konsiderohet për qëllimet e Nenit 12 të KPPK.

## VI. PËRFUNDIMET LIDHUR ME FAKTET DHE LIGJIN

### 6.1. Lidhur me akuzën e Tentativës për Vrasje të Rëndë paraqitur në Aktakuzë

<sup>23</sup> Procesverbal i seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 15 korrik 2010, fq.5 (në gjuhën angleze)

Aktakuza PP. Nr. 112/08, e datës 13 janar 2009, e akuzon të Akuzuarin për veprën penale të Tentativës për Vrasje të Rëndë, sipas Nenit 147, Pika 4 të lexuar me Nenin 20 të KPK. Që të kualifikohet akti i A. A. sipas Nenit 147, Pika 4 të lexuar me Nenin 20 të KPK, duhet të përcaktohet se A. A. tentoi ta privonte B. A. nga jeta, dhe duke vepruar kështu në mënyrë të qëllimshme rrezikoi jetën e një apo më shumë personave. Sipas, përvaktimit të Nenit 147, Pika 4 e KPPK, kërkohet që duhet të ketë pasur një qëllim të A. A. për të rrezikuar jetën e personit/-ave). Megjithatë, rrethanat e kësaj çështjeje nuk identifikojnë që A. A., ndërsa po tentonte të privonte gruan e tij nga jeta, kishte dijeni që po e sulmonte gruan e tij në një mënyrë të tillë dhe në rrethana të tilla, të cilat krijojnë një kërcënim realist se mund të konsiderohet se jo vetëm që ishte në rrezik jeta e B. A., por edhe ajo e personit/-ave tjetër/të tjerë. Për shembull, mjetet e sulmit, të cilat mund të konsiderohen si rrezikim i jetës së personit/-ave tjetër/të tjerë, përfshijnë vrasjen me anë të përdorimit të lëndëve shpërthyesë, shkaktimin e zjarrit, rrëshqitjen e tokës, përmytjet, shembja e një godine, ku përvec viktimit ka gjithashtu edhe person/-a tjetër/të tjerë, ose me anë të shkaktimit të një aksidenti automobilistik, në të cilin ka edhe person/-a tjetër/të tjerë, apo të qëllosh viktimit në një turmë apo në largësi të afërt me person/-a tjetër/të tjerë, ose me anë të helmimit të ujit apo ushqimit, i cili përvec viktimit përdoret edhe nga të tjetër. Në rrethana të vecanta, është mendimi i trupit gjykues, se mënyra me të cilën A. A. tentoi të vraste gruan e tij, me anë të goditjes me thikë, nuk ishin të tilla që ait ë *kishte për qëllim* që po ashtu të rrezikonte edhe jetën e personit/-ave tjetër/të tjerë. Prandaj, trupi gjykues konsideroi se akti i A. A. nuk u kualifikua si Tentativë për Vrasje të Rëndë, sipas Nenit 147, Pika 4 të lexuar me Nenin 20 të KPPK, sic u propozua nga Prokurori në Aktakuzën PP. Nr. 112/08.

## 6.2. Kualifikimi ligjor i aktit të A. A.

a. Trupi gjykues konsideroi se akti i kryer nga i akuzuari A. A. kundër gruas së tij, të kualifikohet si Tentativë për Vrasje, sipas Nenit 146 lidhur me Nenin 20 të KPPK. Neni 20 i KPPK e përkufizon Tentativën si një veprim të qëllimshëm të menjëhershëm drejt kryerjes së një vepre penale, ku veprimi nuk është i përfunduar apo kur elementët e veprës së qëllimshme nuk janë plotësuar.

Duke pasur parasysh Nenet 146 dhe 20 të KPPK, një Tentativë për të kryer Vrasje duhet të jetë *një veprim i menjëhershëm i qëllimshëm që shkon drejt privimit të jetës së një personi tjetër*.

Për të vendosur qëllimin e të akuzuarit A. A., trupi gjykues mori në konsideratë mënyrën me të cilën i akuzuari e kishte kryer veprën penale, mjetin e përdorur nga i akuzuari, karakteristikat e lëndimeve të shkaktuara gruas së tij B. A., dhe

arsyet se përse vepra penale nuk ishte përfunduar. Duke u bazuar në këto konsiderata, prova të vlerësuara si më sipër në këtë aktgjykim, arrihet në përfundimin si më poshtë vijon:

- Në mbrëmjen e datës 20 tetor 2008, rreth orës 20:30 i akuzuari A.A. në shtëpinë e tij, në fshatin H, Komuna e Vushtrisë, nxorri një thikë xhepi, e hapi dhe me të sulmoi gruan e tij. Në atë moment ai e kishte të pamundur të arrinte objektivin e tij, sepse djemtë e tyre, C.A. dhe D.A. ndërhyjnë. Po ashtu, edhe babai i të akuzuarit, E.A. u zgjua dhe ndërhyri, por u shty nga i akuzuari. Prandaj, në këtë moment tri (3) persona në mënyrë aktive u përpoqën të parandalonin të akuzuarin që të sulmonte B.A.
- Duke mos e zbatuar objektivin e tij në shtëpinë e tij, A.A. e ndoqi gruan e tij në shtëpinë e vëllait të tij, F.A., e cila gjendet 100 metra larg nga shtëpia e tij. Ndjekja e B.A. për 100 metra, pasi u tejkaluan përpjekjet e tri (3) personave për ta ndaluar atë, tregojnë në mënyrë të qartë se A.A. në mënyrë të vazhdueshme ndoqi objektivin e tij. A.A. po mbante thikën e xhepit me vete gjatë gjithë rrugës për në shtëpinë e F.A.
- Sapo A.A. e arriti B.A. tek shtëpia e F.A., ai vazhdoi të zbatonte objektivin e tij duke e goditur me thikë B.A. Ai vazhdoi ta zbatonte objektivin e tij pavarësisht nga fakti që djali i tij C.A. ndërhyri mes tij dhe nënës së tij në shtëpinë e F.A.

Rrethanat e sipërpërmendura tregojnë se A.A. ndërmorri një veprim të menjëhershëm të qëllimshëm drejt kryerjes së një vepre penale.

Duke u bazuar edhe në konsiderata të tjera trupi gjykues përcaktoi se veprimi i sipërpërmendur i menjëhershëm i qëllimshëm ishte ndërmarrë nga A.A. drejt privimit të jetës së gruas së tij:

- A.A. përdori thikën kundër gruas së tij. Është njohuri e përgjithshme se thika është një armë me anë të së cilës mund të shkaktohen lëndime vdekjeprurëse.
- A.A. e goditi gruan e tij me thikë në pjesën e sipërme të trupit, aty ku ndodhen edhe organet jetësore. Ai egoditi atë në rajonin e ballit, në rajonin e shpatullës dhe atë të shpatullës së majtë. Vendndodhja e lëndimit në ballë identifikon se objekti i sulmit të të akuzuarit ishte jeta e gruas së tij. Shumë organe jetësore gjenden në atë zonë. Sic është dëshmuar edhe nga Dr. S.S., edhe po qe se vetë lëndimi në kokën e B.A. nuk ishte i rrezikshëm, vendi ku ndohej lëndimi ishte i rrezikshëm.
- A.A. gjithashtu i shkaktoi lëndime edhe djalit të tij C.A. ndërsa ky po e mbronte nënën e tij nga sulmi në shtëpinë e F.A. Fakti që

A.A. e goditi me thikë djalin e tij tregon se A.A. vazhdoi të godiste me thikë edhe pasi djali i tij ndërhyri. A.A. vazhdoi të godiste me thikë në mënyrë të vazhdueshme. Është mendimi i trupit gjykues se ndërhyrja e C.A. nuk e lejoi A.A. të realizonte plotësisht objektivin e tij, ta privonte gruan e tij nga jeta, duke i shkaktuar asaj lëndime vdekjeprurëse me thikë.

- Përfundimi se objekti i sulmit të të akuzuarit ndaj gruas së tij B.A ishte jeta e gruas së tij, theksohet gjithashtu edhe duke pasur parasysh faktin që arsyeya e vetme që A.A. eventualisht ndaloi së godituri gruan e tij me thikë, ishte për shkak se djali i tij C.A. së bashku me vëllain e tij F.A. arritën ta kapin atë, në mënyrë të tillë që e ndërprejnë sulmin e vazhdueshëm me thikë ndaj gruas së tij. Megjithatë, edhe përpara se A.A. të ndalohej, ai kishte shkaktuar një numër të përgjithshëm prej pesë lëndimesh – tri ndaj gruas së tij dhe dy ndaj djalit të tij.

Prandaj, trupi gjykues arriti në përfundimin se i akuzuari A.A. ndërmori një veprim të menjëhershëm të qëllimshëm drejt privimit të jetës së gruas së tij. Synimi i të akuzuarit mbeti i paarrirë për shkak të ndërhyrjes së djalit të tij C.A. dhe vëllait të tij F.A.

Kështu që, akti i kryer nga i akuzuari A.A. kundër gruas së tij B.A. ishte kualifikuar si Tentativë për Vrasje, sipas Nenit 146 lidhur me Nenin 20 të KPPK.

b. Trupi gjykues konsideroi se akti i kryer nga i akuzuari A.A. kundër djalit të tij C.A. të kualifikohet si Lëndim i Lehtë Trupor, sipas Nenit 153, Paragrafi (4) të lexuar me Paragrafin (2) dhe Paragrafin (1), Pika 1 të KPPK.

U përcaktua se:

- A.A. e goditi me thikë djalin e tij C.A., duke i shkaktuar atij dy plagë në shpatullën e djathtë dhe në pjesën e brendshme të kofshës së djathtë. Këto lëndime u shkaktuan ndërsa C.A. ndërhyri për të mbrojtur nënën e tij nga sulmi i babait të tij A.A., që filloi në shtëpinë e tyre dhe vazhdoi në shtëpinë e F.A. Këto lëndime ishin të tilla që ato përkohësisht dëmtuan një pjesë të trupit të C.A.
- Pavarësisht se qëllimi i drejtëpërdrejtë i të akuzuarit A.A. nuk ishte të godiste me thikë djalin e tij C.A., i akuzuari ishte në dijeni se mund të ndodhë që, si rezultat i faktit që i akuzuari vazhdoi të godiste me thikë gruan e tij, ai mund të lëndonte gjithashtu edhe djalin e tij C.A., që vazhdoi të ndërhynte dhe të mbronte nënën e tij nga sulmi. Pavarësisht se C.A. po përpiqej ta ndalonte A.A. nga sulmi ndaj B.A., i akuzuari

- A. A. vazhdoi të godiste me thikë, në këtë mënyrë duke shkaktuar lëndime edhe ndaj djalit të tij C. A.
- Për më tepër, lëndimet e lehta trupore iu shkaktuan C. A. me thikë, që është një armë me anë të së cilës mund të shkaktohen lëndime të rënda trupore ose mund të shkaktohet dëmtimi serioz i shëndetit.
  - Vepra penale e përshkruar më sipër është kryer nga i akuzuari kundër djalit të tij, që është një person me të cilin i akuzuari A. A. kishte një marrëdhënie familjare.

Prandaj, duke pasur parasysh përfundimet e mësipërme për veprën penale të kryer kundër C. A., ajo u kualifikua si Lëndime të Lehta Trupore, sipas Nenit 153, Paragrafi (4) të lexuar me Paragrafin (2) dhe Paragrafin (1), Pika 1 të KPPK.

## VII. PËRCAKTIMI I DËNIMIT

a. Sipas Nenit 146 të KPPK për veprën penale të Vrasjes kryesi i veprës penale do të ndëshkohet me një dënim me burg prej të paktën pesë vjetësh burgim. Sipas Nenit 38, Paragrafi (1) të KPPK dënimi me burgim mund të mos jetë më i gjatë se njëzet vjet. Në rastin e Tentativës, dënimi do të jetë jo më shumë se tri të katërtat e dënimit maksimal, sipas Nenit 65, Paragrafi (2) të KPPK.

Prandaj, për veprën penale të Tentativës për Vrasje sipas Nenit 146 lidhur me Nenin 20 të KPPK – dënimi maksimal mund të mos i tejkalojë 15 vjet burgim.

b. Për Lëndimet e Lehta Trupore, sipas Nenit 153, Paragrafi (4) të lexuar me Paragrafin (2) dhe Paragrafin (1), Pika 1 të KPPK – dënimi i përshkruar është gjashtë (6) muaj deri në tri (3) vjet burgim.

c. Sipas Nenit 64, Paragrafi (1) të KPPK, gjykata do ta përcaktojë dënimin lidhur me një veprë penale brenda kufijve të përcaktuara me ligj për një veprë të tillë penale, duke marrë në konsideratë qëllimin e dënimit dhe të gjitha rrethanat që janë relevante për lehtësimin apo rëndimin e dënimit. Trupi gjykues në përcaktimin e dënimit për veprat penale mori në konsideratë rrethanat e mëposhtme lehtësuese dhe rënduese:

Rrethanat e mëposhtme lehtësuese:

- Lidhur me të dyja veprat penale të Tentativës për Vrasje dhe Lëndimit të Lehtë Trupor, një rrethanë lehtësuese është që palët janë pajtuar. Edhe pse këto deklarata të palëve të dëmtuara B. A. dhe C. A. u vlerësuan me shumë kujdes nga gjykata, ata që të dy, gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të

datës 12 korrik 2010, deklaruan se tani ata do të dëshirojnë të vazhdojnë të jetojnë së bashku me të akuzuarin A.A.

- Lidhur me veprat penale të Tentativës për Vrasje dhe Lëndimeve të Lehta Trupore, një rrethanë lehtësuese është që në kohën e kryerjes së veprave penale, më 20 tetor 2008, i akuzuari A.A. vuante nga crregullimi i personalitetit.

#### Rrethanat e mëposhtme rënduese:

- Lidhur me veprën penale të Tentativës për Vrasje, një rrethanë rënduese është që Tentativa për Vrasje në një moment është kryer në praninë e të paktën tri (3) fëmijëve (nën moshën 18 vjeçare) - D.A., C.A. dhe H.A. Përjetimi i një sulmi të tillë të dhunshëm krijon pasoja traumatizuese për fëmijët. Kjo bëhet edhe më traumatizuese për D.A. dhe C.A., si fëmijë të një nëne, ndaj së cilës drejtohet një sulm i dhunshëm.
- Lidhur me Tentativën për Vrasje, një rrethanë rënduese është është se Tentativa për Vrasje është kryer me intensitet të lartë. I akuzuari A.A. e filloi veprën penale në shtëpinë e tij, dhe pastaj pasi u ndërpre nga anëtarët e familjes së tij, e vazhdoi sulmin në shtëpinë e F.A. edhe pse u ndoq nga djali i tij C.A. që po e mbronte nënën e tij nga sulmi.
- Lidhur me të dyja veprat penale, si Tentativën për Vrasje ashtu dhe Lëndimet e Lehta Trupore, një rrethanë rënduese është sjellja e kaluar e A.A. sic është dëshmuar edhe nga palët e lënduara dhe dëshmitarët, që demonstroi se ai ka qenë agresiv dhe i dhunshëm ndaj anëtarëve të familjes së tij edhe më parë. A.A. është karakterizuar si person i rrëmbyer, që është agresiv ndaj anëtarëve të familjes së tij. Fakti që familja e të akuzuarit përfshin gjithashtu edhe fëmijë (nën moshën 18 vjeçare, përpara datës 20 tetor 2008), me të cilët i akuzuari ka lidhje familjare, e bën këtë sjellje të shkuar agresive dhe të dhunshme edhe më të rëndë si rrethanë.
- Lidhur me Lëndimin e Lehtë Trupor, një rrethanë rënduese është se A.A. e kreu veprën penale të Lëndimit të Lehtë Trupor kundër një fëmije (nën moshën 18 vjeçare, më 20 tetor 2008).
- Lidhur me Lëndimin e Lehtë Trupor, një rrethanë rënduese është se A.A. e kreu këtë veprë të Lëndimit të Lehtë Trupor kundër djalit të tij, C.A. në rrethanën që C.A. po e mbronte nënën e tij nga sulmi.
- Lidhur me Tentativën për Vrasje dhe Lëndimet e Lehta Trupore, një rrethanë rënduese është sjellja e A.A. pas kryerjes së veprave penale. Në vecanti, pasi i akuzuari tentoi të vriste gruan e tij dhe i shkaktoi lëndime të lehta trupore djalit të tij, ai shkoi në shtëpi dhe nuk shfaqti asnjë pendesë apo shqetësim lidhur me mirëqenien e tyre. Ai ishte i qetë dhe piu çaj. Për më tepër, lidhur me Lëndimet e Lehta Trupore, një rrethanë rënduese është se pasi i akuzuari e kishte kryer veprën penale më 20 tetor 2008, ai vazhdoi të ishte i dhunshëm ndaj djalit të

tij, C.A. dhe më 18 dhjetor 2009 përsëri kreu veprën penale të shkakimit të Lëndimeve të Lehta Trupore ndaj C.A.

d. Duke pasur parasysh kufijtë e ndëshkimit të siguruara me anë të KPPK për veprën penale të Tentativës për Vrasje, sipas Nenit 146 lidhur me Nenin 20 të KPPK, dhe veprën penale të Lëndimeve të Lehta Trupore, sipas Nenit 153, Paragrafi (4) të lexuar me Paragrafin (2) dhe Paragrafin (1), Pikën 1 të KPPK, si edhe duke pasur parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese të konsideruara më sipër, u përcaktua ndëshkimi i mëposhtëm kundër A.A.

- Për Tentativën për Vrasje - tetë (8) vjet burgim.
- Për Lëndimet e Lehta Trupore - dy (2) vjet burgim.

Dënimi unik u përcaktua si nëntë (9) vjet burgim, sipas Nenit 71, Paragrafi (1) dhe Paragrafi (2), Pika 2 e KPPK.

e. Lidhur me qëllimin e ndëshkimit, trupi gjykues konsideroi se me përcaktimin e këtij dënimi me burgim, do të përmbushet si detyra e parandalimit individual, ashtu edhe detyra e parandalimit të përgjithshëm.

Së pari, u vlerësua se dënimi unik prej nëntë (9) vjetësh do të parandalojë të akuzuarin të kryejë vepra penale. Një dozë më e lartë burgimi nevojitet për ta përmbushur këtë detyrë. Kjo ndodh sepse i akuzuari paraqitet të jetë një person agresiv ndaj familjes së tij jo vetëm më 20 tetor 2008, por gjithashtu edhe më parë dhe pas datës 20 tetor 2008. Nga dëshmitë e palëve të lënduara dhe dëshmitarëve del se familja e A.A. ka vuajtur nga dhuna në familje që është ushtruar mbi ta A.A. për një periudhë edhe më të gjatë. Edhe pse përmes paraburgimit që ishte përcaktuar fillimisht ndaj të akuzuarit për veprën penale më 20 tetor 2008, pasi u lirua nga paraburgimi, ai e kreu përsëri veprën penale të Lëndimit të Lehtë Trupor kundër djalit të tij C.A., më 18 dhjetor 2009. Prandaj, në rrethana të vecanta një periudhë më e gjatë paraburgimi nevojitet për ta parandaluar A.A. nga kryerja e veprave penale.

Së dyti, masa e përcaktuar e burgimit do ta kryejë punën e saj për të parandaluar persona të tjerë për të kryer vepra penale. A.A. e sulmoi gruan e tij dhe tentoi ta vriste atë, ndërsa i shkaktoi lëndime të lehta trupore djalit të tij, sepse ai nuk mundi të gjente çertifikatën e martesës në shtëpi. **Trupi gjykues thekson se asnjë motiv (arsye) i/e tillë nuk mund të shërbejë edhe në masën më të vogël për të justifikuar një trajtim të tillë ndaj bashkëshortes dhe fëmijës. Një trajtim i tillë i bashkëshortes dhe fëmijëve nuk është i pranueshëm në shoqërinë e civilizuar dhe nuk do të tolerohet. Prandaj, qëllimi i dënimit të shqiptuar është që të ngrisë ndërgjegjen në shoqëri për trajtimin njerëzor dhe të civilizuar të bashkëshortes dhe fëmijëve, dhe do të dërgojë një porosi të fuqishme shoqërisë se trajtimi i tillë i bashkëshortes dhe fëmijëve do të dënohet në përputhje me rrethanat.**

## VIII. SHPENZIMET E PROCEDURËS PENALE

Meqë gjykata e shpalli të akuzuarin A A. fajtor, ai do të riimbursojë shpenzimet e procedurës penale sipas Nenit 102, Paragrafi (1) të KPPK me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit gojor dhe atij me shkrim. Një vendim i vecantë lidhur me sasinë e shpenzimeve do t'i dorëzohet të akuzuarit, pasi të merren të dhënat e tilla, sipas Nenit 100, Paragrafi (2) të KPPK.

### Gjykata e Qarkut në Mitrovicë P. Nr. 06/09

Përgatitur në anglisht, gjuhë e autorizuar.

Procesmbajtësi:

Zane Ratniece  
Oficer Ligjor i EULEX-it

Kryetare e Trupit Gjykses:

Hajnalka Veronika Karpati  
Gjyqtare e EULEX-it

Anëtarët e Trupit Gjykses:

Charles L. Smith, III  
Gjyqtar i EULEX-it

Nikolay Entchev  
Gjyqtar i EULEX-it

**Këshilla Ligjore:** Personat e autorizuar mund të ushtrojnë ankesë në formë të shkruar kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh që nga data e marrjes së kopjes së aktgjykimit, sipas Nenit 398, Paragrafi (1) të KPPK.